



Drejt një Kodi të ri të etikës në Policinë e Shtetit

*Udhëzues i hartuar në kuadër të projektit “Forcimi i integritetit të
Policisë së Shtetit në Shqipëri”*

Përgatiti:

Merlinda Andoni

IDM, Tiranë 2014

Përmbajtja

I.	Hyrje.....	3
II.	Sfidat aktuale të etikes policore në Shqipëri	5
III.	Drejt një kodi të ri të etikës.....	13
IV.	Praktika të mira ndërkombëtare.....	16
V.	BIBLIOGRAFIA.....	19

I. Hyrje

Etika konsiderohet si shkenca e sjelljes, apo edhe si mjeti me anë të së cilit vlerësohen veprime, reagime apo sjellje të gabuara ose të drejta brenda një institucioni. E aplikuar në policim, literatura, raportet si edhe praktikrat e mira ndërkombëtare, europiane dhe rajonale vërtetojnë se ndërtimi i një kodi të mirë etike rrit efikasitetin e punës së policisë në përgjithësi, ashtu si kundër përmirëson cilësinë e policimit si proces. Në këtë raport, *etika* përkufizohet si një koncept i cili shfaq karakter edukativ, funksional, integruar, reflektues e realiteteve sociale, politike dhe ekonomike, si edhe në proces bërjeje.

Raporti i Institutit për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM) “Integriteti dhe korrupsioni policor në Shqipëri” nxjerr në pah faktin që *Kodi Etikës së Policisë së Shtetit* shqiptar duhet të reflektojë realitetin. Kritikët e kodeve të etikës, i qendrojnë pikëpamjes se kodet e shkruara pa orientim praktik apo që nuk reflektojnë realitetin, janë të pajetë. Njëkohësisht, në mënyrë që të jenë sa më shumë funksionale, kodet duhet të shoqërohen me shembuj të sjelljes etike. Më konkretisht, etika në policim nuk duhet të jetë vetëm “*Bibla e Sjelljes*” e cila tregon sesi: *Duhet, Mund, Është e Detyrueshme*. Dokumenti i *Kodit të Etikës*, duhet të shërbejë si pasqyrë e parimeve dhe vlerave që shërojnë deformimet apo keqtrajtimet e ushtrimit të policimit, konform parimeve universale, si edhe të plotësojnë vakumet e reflektuara nga studimet e realizuara.

Studimi i IDM sugjeron se mungesa e efikasitetit të Kodit aktual të Etikës (1998) vërehet qartë. Sipas përjasjes integriteti policior bazohet në dimensionin e rregullave organizative, mekanizmit të parandalimit dhe kontrollit, heshtjes, si edhe pritshmërisë së publikut. Gjetjet e studimit, nxjerrin në pah faktin se rregullat e sjelljes, përfshirë këtu edhe ato antikorrupsion, duhen hartuar, miratuar dhe komunikuar radhëve të policisë në mënyrë të tillë që ato të jenë pjesë integrale e procesit. Kjo është e rëndësishme pasi punonjësit e policisë duhet të

përbrendësojnë rregulloret si edhe parimet e formuluar nga vetë organizata. Sipas studimit, ndodh shpesh që në mungesë të njohjes së këtyre rregullave punonjësit e policisë i nënshtrohen rregullave të pashkruara duke prodhuar te ashtuquajturin "**kodi i heshtjes**". Në mënyrë informale kodi i heshtjes ndalon ose dekurajon punonjësit e policisë të raportojnë sjelljet korruptive të kolegëve të tyre. Një kod i tillë çënon, krijimin e një kulture të mirë pune me integritet në radhët e policisë, e cila nuk toleron punonjës që abuzojnë me të drejtat dhe privilegjet që ofron profesioni. Konkretisht, denoncimi i korrupsionit brenda radhëve të policisë gjendet në nivele mjaft të ulëta. Vetëm 5% deklarojnë se kanë denoncuar eprorin dhe vetëm 8% se kanë denoncuar një oficer policie (jo epror). Problematika të tjera të Kodit aktual përfshijnë: mungesa e një dokumenti fleksibël që përfaqëson parimet e mira në kontekstin në të cilin aplikohet; deformimi i karakterit funksional dhe edukativ; zgjerimi hapësirave interpretative që favorizojnë deformimet; mënyra e shkrimit të tekstit i cili nuk është gjithëpërfshirës; kufizimi mbi monitorimin dhe kontrollin nga palët e treta të interesuara si për shembull gjyqësori etj. Kodi i ri i etikës duhet të reflektojë mbi këto problematika, parimet e gjithëpranuara të etikës policore si edhe të mundësojë hapësira për rifreskimin e tij për të përmbushur standartet e një dokumenti original, edukativ, funksional dhe përfaqësues që ndihmon në rritjen e efikasitetit, imazhit të mirë, besimit dhe ndërgjegjësimit mbi praktikën e duhur në radhët e policisë.

II. Sfidat aktuale të etikës policore në Shqipëri

Ky dokument bazohet në trajtesën e literaturës ndërkombëtare dhe kombëtare në lidhje me etikën si shkencë dhe disiplinë profesionale, etikën në policinë e shtetit, kodin e etikës shqiptare, europiane, britanike si edhe instrumentë të tjerë të rëndësishëm ndërkombëtar plotësues, ashtu si kundër edhe në studime e raporte specifike mbi problematikat e policisë së shtetit shqiptar. Ne vijim, ky seksion trajton problematikat kryesore dhe gjetjet lidhur me Kodin aktual të Etikës së Policisë së Shtetit Shqiptar, për të mbërritur me tej tek sugjerimet mbi procesin e hartimit të kodit të ri dhe përmbajtjes së tij për të reflektuar realitetin vendas.

1. Mungesa e një dokumenti fleksibël që lejon përfaqësimin e parimeve dhe vlerave të mira të shoqërisë shqiptare

Në fushën e policimit koncepti modern i cili trajton etikën si elementin kyç në zbatimin me efektivitet të rolit të policisë, propozohet për herë të parë nga Pollock-Byrne (1998) and Kleinig (1996) në formulimin e modelit social të policimit, ndryshe njohur si *modeli social i sigurisë së komunitetit*. Autorët nënvizojnë nevojën e një përkufizimi më të gjerë të përshkrimit të policimit si koncept. Sipas këtij përkufizimi policimi nuk konsiston vetëm në luftën kundër krimit, por për më tepër në shërbimin me etikë ndaj publikut. Ndërsa Kleinig e plotëson modelin, duke theksuar faktin se modeli i mbrojtjes sociale inkorporon luftën kundër krimit dhe shërbimin e policëve ndaj komunitetit, një sërë autorësh të tjerë si Muir (1977) and Goldstein (1977), Delattre (1989) and Sherman (1985) theksojnë rolin e etikës në përmbushjen e qëllimeve të policimit të mirë. Në tërësi autorët e përmendur e shohin policinë jo si institucion burokratik, por profesional me fokus aplikimin në praktikë të standarteve etike dhe shërbimit me vlera.

Etika konsiderohet si mjeti normativ me anë të së cilës vlerësohet nëse veprime, reagime, apo kundër veprime ndaj sjelles profesionale janë të gabuara apo të drejta. Në vetvete, etika këshillon sesi gjërat duhet të bëhen drejtë. Pjesa më e madhe e literaturës së etikës i referohen kësaj llogjike në trajtesën e konceptit.

Ndërsa aplikimi në praktikë ndryshon. Aplikimi në raste konkrete ka treguar që etika nuk duhet të shfaq vetëm karakter përshkrues parimor. Në këtë këndvështrim dilema më e madhe si edhe diskutimet që lidhen me konceptin duhet të përcaktojnë qëndrimin nëse:

- a. **Së pari**, Kodi i Etikës duhet të trajtohet si “bibla e sjelljes”, dhe të ketë karakter vetëm përshkrues? Më konkretisht, të jap udhëzime të qarta dhe të zbatueshme, ndaj parimeve të përgjithshme të tilla si psh integriteti, transparencja, etj. A duhet një nënpunës, apo epror të gënjejë, vjedhë, nënshtrijë, respektivisht? Ky qëndrim bazohet në konceptin klasik të termit “etikë”, i cili lidhet më së tepërmi me moralin dhe vlerat. Më specifikisht vlera duhet të na udhëheqin sesi duhet të sillemi dhe veprojmë. Konsiderohen vlera morale të tilla si: respekti, përgjegjësia, llogaridhënia, drejtësia, transparencja, komunikimi mirë, etj (Ethics and Police 2008).
- b. **Së dyti**, duhet ti përgjigjet pyetjes, nëse Kodi i Etikës duhet të jetë udhëzues i detyrueshëm i cili duhet të aplikohet në zgjedhjen e çështjeve në raport me qëndrimet ndaj individëve bazuar në raste dhe situata konkrete. Ky qëndrim bazohet në konceptin, *modern të etikës* që lidhet me përkthimin e vlerave morale në ligj, rregulla, ushëzime apo edhe direktiva, të cilat duhet të bazohen në ushtrimin e profesionit me bazë etikën dhe respektimin e vlerave në shërbimin ndaj qytetarit (Pollock-Byrne, 1998).

Kodi aktual i Etikës së Policisë së Shtetit, reflekton më tepër karakter klasik detyrues dhe përshkrues të objektivave dhe detyrimeve të policisë së shtetit, sesa atë të një dokumenti udhërrëfyes të parimeve të cilat duhet të udhëheqin punën e përditshme të policisë së shtetit në zbatimin e mirë të detyrave dhe respektimin e të drejtave me profesionalizëm dhe përjasje ndaj qytetarit. Kodi i Etikës shfaq mungesë të theksuar të reflektimit të parimeve thelbësore të cilat

duhet të shoqërojnë Policinë e Shtetit në përmbushje të detyrave dhe detyrimeve të tyre.

Parime të rëndësishme të policimit si; përgjegjshmeria; profesionalizmi dhe pavarësia ;integriteti; lidershipi; objektiviteti; transparencja; paanshmëria; respekti për barazi para ligjit ; Vetëmohim ; Mbrojtja e reputacionit ; konfidencialiteti, mungojnë ose janë të përmendura indirekt. Ndërkohë që karakteri detyrues shprehet qartë. Më konkretisht neni 16 Kodit Aktual të Etikës së Policisë së Shtetit mëton se:

Dispozitat e këtij Kodi, si dhe legjisllacioni në fuqi që lidhet me funksionimin e policisë, janë të detyrueshme për t'u përvetësuar dhe asimiluar në të gjitha format e përgatitjes teknike e profesionale të policisë shqiptare. Çdo punonjës që fillon punë në radhët e policisë, nënshkruan një deklaratë, me anën e së cilës ai shprehet i një mendimi me dispozitat e këtij Kodi (Kodi Etikës; 1998).

Krahasimi me kodet aktuale të etikës europiane dhe modele të mira ballkanike (me kontekste të përafërta historike, politike, sociale dhe ekonomike), si për shembull Kodi i Etikës së Policisë së Serbisë dhe Sllovenisë, tregojnë për përdorimin e një teksti shumë herë më të përparuar i cili bazohet në ndërthurjen e reflektimit të parimeve në tekst, si kundër edhe zbatimin e detyruar në të. *Natyrrshëm problematika e parë dhe rekomandimi njëkohësisht mbi Kodin aktual të Etikës lidhet pikërisht me përbërjen konceptuale të Kodit të Etikës si edhe karakterin e tij detyrues apo jo, dhe në çfarë niveli duhet të jetë detyrimi?*

Përgjithësisht amendimet, modifikimet dhe rifreskimet e ligjeve parësore karakterizohen nga procedura të gjata dhe burokratike, të cilat pengojnë ndryshimet e nevojshme në document sa herë ato janë të nevojshme. Në të

njëjtën kohë karakteri detyrues me ligj parësor pengon rifreskimin e dokumentit, duke iu përshtatur nevojave aktuale si edhe ndryshimeve dinamike të policimit si proces, kontekstit politik, social dhe ekonomik mbi të cilin zbatohet, ashtu si kundër edhe përafritit të legjislacionit me Bashkimin Europian.

Për këto arsye, është e këshillueshme që Kodi i Etikës të rifreskohet periodikisht si edhe të aplikohet legjislacioni dytësor, në mënyrë që dokumenti të evitojë procedurat e tejzgjatura të modifikimit.

2. Teksti konsiderohet i vjetër dhe jo përfaqësues i dinamikave të reja politike, sociale si edhe ekonomike të vendit

Literatura dhe praktikat e mira vërtetojnë se kodi i etikës nuk duhet të konceptohet si tekst që shkruhet vetëm njëherë dhe i izoluar nga realiteti. Në qoftë se kjo ndodh atëherë kodi i etikës nuk plotëson objektivat kryesorë si edhe standartet. *Standarte të cilat për këtë raport i referohen, përkufizimit të etikës profesionale si një proces i cili duhet të reflektojë karakter funksional, edukativ, integruar, reflektues i realiteteve sociale politike dhe ekonomike, gjithëpërfshirëse, si edhe në proces bërjeje (Seumas Miller, 2002).*

Kodet e etikës, minimalisht duhet të reflektojnë situatën në të cilën gjendet institucioni në të cilin aplikohet (policimi në rastin konkret). Kodi aktual i Etikës së Policisë së shtetit shqiptar daton nga viti 1998-të. Me një vëzhgim të thjeshtë kuptohet se më shumë se 16 vjet nga shkrimi i tij, konsiderohet jo aktual dhe i vjetër. Për më tepër, një nga aspektet më të rëndësishme të Kodit të Etikës është nevoja për tu përsosur, përpunuar vazhdimisht pa ndryshuar në vetvete. Ndryshimet duhet të bëhen sa herë konstatohen dilema dhe probleme në dinamikën e punës së Policisë. Dialogu i vazhdueshëm dhe reflektimi rreth vlerave etike prodhon dhe nxit ndjeshmërinë etike të punonjësve dhe drejtuesve të policisë si dhe konsensusin e nevojshëm rreth zbatimit dhe respektimit të vlerave në punën e përditshme.

Ndryshimet e brendshme të shoqërisë shqiptare, proceset integruese , përafrimi legjislacionit, zhvillimet politike ndërkombëtare, ashtu si kundër edhe vetë natyra e policimit si në procese, struktura edhe mëndësia, kanë ndryshuar prej vitit 1998-të.

3. Kodi i etikës reflekton karakter përshkrues

Në mënyrë që të minimizohen deformimet dhe keqpërdorimet e konceptit, është e rëndësishme të kuptojmë sesi mund të mirëpërdorim etikën si koncept dhe aplikimin e saj në një dokument të shkruar real. Etika profesionale ndihmon të njihet **se çfarë është e drejtë dhe e gabuar në punë**, ashtu si kundër edhe sjellja profesionale në raport me kolegët, eprorët edhe qytetarët të cilët janë të ndikur nga shërbimet që institucionet ku aplikohet ofrojnë. Vëmendja për etikën, është vecanërisht e rëndësishme në momentet kur ndryshime thelbësore ndodhin në institucion.

Kodi Etikës duhet të reflektojë sa më shumë realitetin dhe mos të shkruhet si një tekst i cili thjesht kopjon dhe përkthen nga dokumenta të ngjashëm, qofshin këto edhe modelet e aplikuara më të suksesshme. Kritikët e kodeve të Etikës, i qendrojnë pikëpamjes se kodet e shkruara pa sens praktik, janë të pajetë. Kodet duhet të shoqërohen me shembuj të sjelljes etike. Më konkretisht, etika në policim nuk duhet të jetë vetëm: *Duhet, Mund, Është e Detyrueshme*. Morali dhe Etika duhet të ndjehen dhe të aplikohen në praktikë. Kodet e etikës duhet të shkruhen në formatin praktik, i cili shoqëron me shembuj konkret aplikimin e vlerave dhe parimeve. Këshillohet ky format për të shmangur disa problematika që vijnë nga formati në të cilin kodi i etikës vetëm përshkruan.

Morali apo vendimet e marra në shkelje të veprimeve kundër etikës janë çështje të cilat mbartin në vetvete nivel të lartë të subjektivitetit dhe interpretimit. Studimet tregojnë se vendimarrja në të tilla raste të komplikuara sjellin kundër

reagime të forta, fakte apo argumenta, duke e bërë rastin gati gati të pazgjidhshëm (Seumas Miller; 2002).

Kodet e etikës, përshkruajnë ose dënojnë veprime, zakone apo edhe sjellje. Pyetja e parë që mund të lind është interpretimi i duhur apo jo i veprimeve, sjelljeve, apo zakoneve. Nëse kodet bazohen vetëm në përshkrimin e parimit, arsyetimi në shkelje të tij ngelet çështje interpretimi i cili lejon abuzimin me atë ose në rastin më të mirë deformimin e parimit. Për të shmangur, deformimet shembuj shpjegues të veprimeve që rrjedhin nga parimi janë të rëndësishëm për të ndihmuar në aplikimin e mirë të kodit. Kodi i Etikës së Policisë shqiptare, me ligjin Nr.8291, datë 25.2.1998, përbëhet gjithsej nga 18 nene të cilat kanë karakter vetëm përshkrues (Kodi Etikës së Policisë 1998).

4. Kodi aktual pengon përmbushjen e rolit funksional, edukativ dhe gjithëpërfshirës

Kodet e etikësduhet të luajnë rol funksional, edukativ dhe gjithëpërfshirës. Duke përshkruar të drejtat dhe detyrimet, kufizimet në aktivitetin e tyre, etj, kodet ushtrojnë edhe funksion edukativ. Njohuritë e kodit të etikës janë njëkohësisht njohuri të parimeve dhe vlerave që shoqërojnë policimin në rastin konkret. Rrjedhimisht, punonjesit e policisë apo edhe palët e treta të interesuara në Kodin e Etikës, duhet ta zotërojnë këtë njohuri. Ky zotërim ndryshe njihet si praktikë, duke qenë se kundërshton vetëm leximin teorik të Kodit. Është e rëndësishme që të zotërohet njohuria mbi vlerat dhe principet në raport me sesi mund të aplikojmë në modele të mira këto vlera më së tepërmi, sesa shqetësimi se çfarë përshkruan parimi apo vlera X (Judith Lichtenberg; 1996).

5. Lë vend për deformime dhe keqpërdorime në radhët e Policisë së shtetit

Kodi Etikës duhet të përforcojë efikasitetin e sistemeve të sjelljes, të minimizojë dilemat në zgjidhjen e situatatave në të cilat përdoret si referencë, të minimizojë

riskun e deformimeve të parimeve, si edhe të përshtasë sanksionet e marra ndaj abuzimit me ato.

Vetë formati i parimeve dhe vlerave është problematik duke qenë se shprehen në një fjali të vetme dhe nga natyra janë përgjithësues. Përvec kësaj, duke qenë se parimet dhe vlerat janë të përgjithshme duhen vendosur dhe shpjeguar me shembuj konkret sipas kontekstit ku aplikohen (Margaret Coady and Sidney Bloch; 1996). Për shembull, integriteti apo jo-korruptueshmëria janë parime apo vlera të cilat nuk i takojnë detyrimisht vetëm policisë së shtetit, por të gjitha institucioneve në shërbim të qytetarit qofshin këto publike apo private. Është e rëndësishme që, Kodi i Etikës, të shërbejë si document i cili mënjanon praktika të këqija të keqpërdorimit.

Studimi i OSBE-së *"Udhërrëfyesi për Policim Demokratik nga Këshilltari i Lartë Policor i Sekretarit të Përgjithshëm të OSBE-së" i vitit 2008*, vendos theksin tek korrupsioni si çështja më problematike mbi integritetin e Policisë së shtetit

Më tej studimi sugjeron, se duhet përforcuar efikasiteti i sistemeve të disiplinës dhe sanksioneve:

Lufta kundër korrupsionit kërkon zbatimin e politikave dhe të kodeve të sjelljes anti-korrupsion në kryerjen e saktë, të ndershme dhe të përshtatshme të detyrave policore, si dhe masa efektive për zbatimin e këtyre politikave në të gjitha nivelet e policisë. Një zgjidhje efektive duhet të ketë për synim jo vetëm zgjidhjen e problemit rrënjësor të të ardhurave të ulëta, dhe në veçanti të mundësive në lloje të caktuara policimi për të marrë ryshfete, por duhet të përforcojë gjithashtu efikasitetin e sistemeve të disiplinës dhe sanksioneve

Aktualisht Kodi Etikës së Policisë shqiptare i vitit 1998, sipas edhe raporteve të lartpërmendura, lë vend për deformime si edhe trajtimin si një dokument me

vakume të thella që nuk reflekton nevojshmërinë dhe problematikat aktuale të veprimtarisë së mirë të Policisë së shtetit, ashtu si kundër lejon keqpërdorimin nga individit duke rritur dilemat në zgjidhjet konkrete të situatave.

6. Mungon koncepti përfshirës, orientuar nga praktika dhe trajnimi në vazhdimësi

Njohuritë praktike mbi parimet dhe vlerat si edhe aplikimi i tyre në realitet nuk janë statike, ato ndryshojnë (Stephen Barker; 1992). Kodi i etikës si një dokument edukativ në proces bërjeje duhet të shoqërohet me trajnime të vazhdueshme gjatë përdorimit të tij. Vetë problematikat që lidhen me etikën si edhe zgjidhjet e tyre ndryshojnë, kështu që rishikimi i kodit të etikës, edukimi dhe rifreskimi i njohurive, trajnimet e vazhdueshme janë nevojshmëri. Trajnime të vazhdueshme përveç funksionit edukativ, rrisin edhe nivelin e kulturës së punës brenda institucionit (Manning 1997: Sherman 1982).

Në Kodin aktual të Etikës vërehet mangësi përse i takon orientimit praktik me shembuj, në mënyrë që të bëhet më thjeshtë i kuptueshëm nga palët e interesuara, si edhe të rrit nivelin e kulturës së mirë të punës në institucion. Përfshirja e punonjësve në trajnime të cilat lejojnë diskutimet, interaktivitetin përforcojnë dijet mbi kodin e etikës, rritin nivelin e kulturës së punës në kolektiv, rritin ndërgjegjësimin mbi vlerat dhe parimet dhe shkeljet ndaj tyre, rritin përgjegjësinë ndaj publikut (Manning 1997: Sherman 1982).

Aktualisht, në policinë e shtetit një kulturë e tillë ka nevojë që të zhvillohet më tej. Studimi i fundit i IDM-së tregon se në përqindje të konsiderueshme **mungesa e kulturës së punës** si një ndër shkaqet që ndihmon në rastin e korrupsionit në policinë e shtetit sipas publikut qendron në nivelin **36%** në rastin e **punonjësve të policisë**. Kulturë e cila, zbehet nëse marrin në konsideratë edhe mungesën e theksuar të trajnimeve në policinë e shtetit, mbi forcimin e saj. Një pjesë e mirë e të anketuarve në studim, **48% e tyre, theksojnë faktin se mungesa e trajnimeve**

është një tjetër faktor i rëndësishëm i cili nxit korrupsionin në strukturat e policisë. Ndërsa, nga anketimet me punonjës së policisë përgjigjet gjenden sërish në nivele të konsiderueshme. Kështu 24, 5% e policëve të pyetur mendojnë se faktor në rritjen e masës së korrupsionit si fenomen në policinë e shtetit vjen edhe si pasojë e kulturës në punë. Përforcuar nga 28.8% të përgjigjeve të anketuarve, të cilët pohojnë se mungesa e trajnimeve në policinë e shtetit është gjithashtu faktor i rëndësishëm për shpjegimin e korrupsionit në rradhët e policisë.

7. Kufizon punën e mekanizmave kontrollues dhe monitorues

Kodi aktual i Etikës i drejtohet vetëm policisë së shtetit, duke lënë jashtë palët e treta të interesuara. Kufizon punën e mekanizmave kontrollues, qoftë të brendshëm (monitorime periodike të nevojshme, apo përpunim i informacionit mbi ngritjen e strategjive reformuese për policinë e shtetit), apo edhe të jashtëm (shoqëria civile, organizata monitoruese ndërkombëtare, gjykata, etj). Është i kufizuar në reflektimin e parimeve që shmangin veprimtaritë kriminale dhe që zvogëlojnë njëkohësisht ndëshkimet apo edhe dilemat. Shkrimi i parimeve sa më të qarta dhe praktike, mundëson përsosjen e mekanizmave si edhe lehtëson punën e strukturave kontrolluese dhe monitoruese.

III. Drejt një kodi të ri të etikës

Referuar instrumentave ndërkombëtare, dhe kombëtare në lidhje me Detyrën e Policisë së shtetit por edhe kodit të etikës, raporteve mbi punën e policisë së shtetit, emëruesi i përbashkët është vetëm një (pavarësisht gjuhës së shkruar): *Policia e Shteti krahas detyrave duhet të funksionojë në bazë të parimeve bazë të instrumentalizuara në këto dokumenta, apo edhe si nevojshmëri e situatave dhe kontekstit të shoqërisë në të cilat aplikohet*. Theksi vendoset tek vlerat si për shembull: integriteti dhe përgjegjshmëria (pa nënvlerësuar këtu parimet e tjera bazë

mbi të cilat duhet të operojë, dhe që do të përmenden në paragrafët më poshtë);
Disa nga dokumentat referues janë:

- Kodin Evropian i Etikës Policore (KEEP), Këshilli i Evropës, 2001
- Kodi i Sjelljes për Punonjësit e Zbatimit të Ligjit, OKB, 1979
- Rezoluta 690 (1979) mbi Deklaratën për Policinë, Këshilli i Evropës, 1979
- Parime të Komitetit për Parandalimin e Torturës (KPT)
- Raporte të Komitetit Evropian për Parandalimin e Torturës dhe të Trajtimit ose Dënimit Çnjerëzor dhe Poshtëruar (KPT) për Shqipërinë

Policimi konsiderohet si manifestimi më i dukshëm i autoritetit shtetëror. Ndër detyrat më të rëndësishme të saj janë:

1. Rruajtja dhe mbrotja e qetësisë publike dhe rendit
2. Mbrotja e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut
3. Parandalimi dhe lufta kundër krimit
4. Dhënia e ndihmës dhe shërbimit ndaj publikut
5. Përdorin autoritetin e shtetit në interes të popullit

Për të arritur objektivat sa më lart, duke qenë se policia ka ; (a) Pushtet te vecantë për ti hequr përkohësisht lirinë njerëzve; (b) Kufizuar përkohësisht të drejtat dhe liritë themelore; (c) Në rrethana të skajshme mund të përdor edhe dhunën vdekjeprurëse , cdo nëpunës i saj duhet minimalisht të njoh detyrimet dhe respektimin e parimeve që ky profesion **kërkon**. Parimet si integriteti, përgjegjshmëria, transparenca, vetëmohimi, paanshmëria, lufta kundër korrupsionit etj, duhet të theksohen qartë në kodin e ri të Etikës, në mënyrë që dilemat dhe keqpërdorimi pushtetit të minimizohen. Vëmendja ndaj etikës së punës është mjaft e rëndësishme dhe vendimtare kryesisht edhe për krijimin e një kulture pune më të thelluar e cila ndihmon drejtuesit dhe punonjësit ne sensibilizimin mbi veprimet apo vendimet që duhet të marrin në situata të ndryshme.

Nje dokument i mirë përgatitur i Kodit të Etikës, ndihmon që:

1. Të mbahet nivel i domosdoshëm i principeve dhe moralit sidomos në situata të vështira të vendimarrjes
2. Kodi i Etikës kultivon frymën e bashkëpunimit dhe kolektivitetit
3. Përmirëson në mënyrë thelbësore kulturën e punës
4. Kodi Etikës mbështet dhe ndihmon zhvillimin profesional dhe botëkuptimor të punonjësve
5. Ndhmon në përgatitjen e strategjivë të moralit të mirë dhe të ligjshëm
6. Ndhmon të shmangen veprimet kriminale dhe njëkohësisht të zvogëlojë përfshirjen në atë
7. Kodi i mirë përgatitur nxit imazhin pozitiv në publik
8. Legjitimon veprimtarinë e drejtë midis vartësve dhe nëpunësve
9. Institucionalizon veprimin e drejtë konform të drejtave dhe detyrimeve për cdo punonjës së Policisë

Dobitë e lartpërmendura të reflektuara në Kodin e Ri të Etikës, përforcojnë klimën e mirë të bashkëpunimit, transparencës, botëkuptimit të punonjësve të policisë në lidhje me vlera si transparenca, integriteti, zvogëlojnë përfshirjen dhe dënimin e akteve korruptive dhe kriminale, legjitimon respektin dhe institucionalizon integritetin në veprimin e drejtë.

Për të prodhuar një kod etikë sa më shumë të dobishëm, mbi bazën e problematikave të reflektuara më lart, rekomandimet e mëposhtme sugjerohen të merren në konsideratë:

- Në konceptimin e tekstit sugjerohet aplikimi i përfaqjes moderne, të modelit social për sigurinë e qytetarëve, e cila reflekton ndërthurje të parimeve më të rëndësishme që duhen shprehur në dokument, në përmbushje të të drejtave dhe detyrimeve të Policisë e Shtetit, me zbatimin e detyruar.
- Rekomandohet ri-freskimi, modifikimi i tekstit duke respektuar standartin e rishkrimit të një teksti origjinal. Cfarë do të thotë që duhet të reflektojë realitetin e situatës së policisë dhe policimit në Shqipëri, kultura e punës, komunikimi brenda radhëve të policisë, si edhe reflektim i realitetit social-politik dhe ekonomik në vend.
- Kodii Etikës duhet të sigurojë përmbushjen e kriterëve bazë të Etikës: funksionale, edukative, integruese, gjithëpërfshirëse, reflektuese e realiteteve si edhe konceptimi si tekst në proces bërjeje.

- *Rekomandohet miratimi I Kodit te ri neprmjet nje akti nenligjor. Arsyerja, e ndryshimit lidhet me dinamikën e vetë Policimit si process, Institucionit, si edhe zhvillimeve politiko, sociale dhe ekonomike të vendit,.*
- *Përpilimi i një dokumenti sa më të plotë, nxit efektshmërinë e punës në Policinë e shtetit, ashtu si kundër përmirëson imazhin dhe besimin ndaj policisë së shtetit. Për këtë arsye punonjësit e policisë duhet të bëhen pjese e konceptimit, ashtu si kundër edhe modifikimeve apo rifreskimeve që mund ti bëhen në kohë. Sugjerohen focus grup, intervistat, apo edhe trajtimi i rasteve konkrete si burim informacioni në trajtesën e Kodit. Prodhimi I moduleve trajnuese dhe perditesimi I vazhdueshem I njohurive te punonjesve mbi Kodin duhet gjithashtu te marre vemendjen e duhur,.*

IV. Praktika të mira ndërkombëtare

Kodi European i Sjelljes

Kodi European pasqyron vlerat më të mira të policimit etik dhe demokratik. Kodi reflekton parime europiane të përbashkëta si edhe jep udhëzime të përgjithshme në lidhje me objektivat, performancën si edhe përgjegjësinë e policimit në mbrojtje të të drejtave të njeriut në shoqëri demokratike që udhëhiqen nga e drejta e ligjit dhe morali i mirë (European Code of Ethics; 2001).

Një tekst relativisht i gjatë dhe shpjegues në detaje, orientohet nga përqsasja e policimit për komunitetin e cila vendos në raport te drejtë policinë e shtetit dhe qytetarin në vecanti, si edhe shoqërinë në tërësi. Kodi Etikës së Policisë së Shtetit duhet të jetë një tekst që shkruhet jo vetëm për radhët e policisë dhe palëve të treta si për shembull, monitoruese, kontrolluese apo edhe konsulentë të shoqërisë civile, por mbi të gjitha duhet ti shërbejë edhe komunitetit si edhe të reflektojë këtë marrëdhënie të ndërsjelltë. E ndarë në seksione të rëndësishme vëmendje të vecantë në këtë kod i kushtohet temave si më poshtë:

- Marrëdhënia midis policisë dhe gjyqësorit
- Organizimi strukturor i policisë

- Udhëzime për ndërhyrjen e policisë dhe veprimevet të saj
- Përgjegjësia dhe monitorimi / kontrolli i policisë
- Kërkimi dhe bashkëpunimi ndërkombëtar

Kodi sugjeron që në shkrimi i Kodeve të Etikës kombëtare, duhet të shoqërohet me shembuj konkret të mbështetur në kontekste specifike si edhe trajnime të vazhdueshme në mënyrë që të përbrendësohet dhe kuptohet qartë. Përvec parimeve dhe vlerave universale të policimit demokratik të shprehura në tekst, Kodi European udhëzon se specifikisht kodet kombëtare, duhet të reflektojnë mbi të gjitha problematika të realiteteve respektive. Modeli është i shoqëruar edhe me një momerandum shpjegues praktik, në të cilin gjenden shumë shembuj sjelljesh etike.

Gjatë shkrimit sugjerohet, që të përzgjidhen ato vlera dhe parime që i përshtaten problematikave të policimit etik kombëtar. Kështu për shembull në nenin 21 të kodit european i cili trajton fenomenin e korrupsionit shprehet qartë se nuk ekziston një përkufizim ndërkombëtar sa i takon korrupsionit. Cfarë konsiderojmë korrupsion ndryshon nga një shtet në tjetrin .Konventa e Ligjit kundër Krimeve të Rënda dhe Korrupsionit e vitit 1999 nuk ofron një përkufizim përgjithësues përfundimtar të korrupsionit. Zakonisht korrupsioni trajtohet si abuzimi me pozicionin e policit. Neni 21, thekson fortë faktin se inkurajon vendet anëtare të përcaktojnë çfarë do të thotë korrupsion, kultura e korrupsionit në vendet konkrete, impakti shoqërisë, dhe më pas të përshkruhen vlerat dhe parimet mbi këtë fenomen.

Kodi european rekomandohet jo vetëm si praktikë ndërkombëtare e parimeve më të mira universale të policimit demokratik, por edhe si pjesë e pandashme e përafrimit të legjislacionit shqiptar me atë european.

Kodi Britanik

Kodi i etikës së policisë britanike është shembulli i shkrimit kryekëput të Kodit të Etikës drejtuar kah praktikitetit. Mënyra sesi kodi është konceptuar është sa gjithëpërfshirëse në filozofinë e shkrimit, aq edhe praktike (ilustruar me shembuj konkret në tërësinë e vetë). Disa nga çështjet e trajtuara janë: menaxhimi i sjelljes menaxheriale, reagime të nivele të ulëta të menaxhimit ndaj vlerave apo parimeve, vlerësimet formale dhe investigimi, etj (Code of Ethics; 2014). Mënyra sesi kodi është shkruar ndan në seksione (a) shpjegimin e parimit ose vlerës; (b) pritshmëritë që duhen të plotësohen nga sjellja; (c) shembuj. Në vijim, ilustrohet në trajtën e shembullit parimi i ndershmërisë dhe integritetit:

Ndershmëria dhe Integriteti

Përshkrimi i standartit: do të jem i ndershëm dhe veprojë me integritet gjatë ushtrimit të detyrës. Nuk do të kompromentohem apo të abuzojë gjatë detyrës. **Sipas këtij standatit pritet që të plotësohen këto sjellje si më poshtë:**

- sjellje me integritet gjatë gjithë kohës
- nuk përdoret ID policore për qëllime vetjake
- sipas rolit që mbani në policinë e shtetit duhet të fitoni autoritetin dhe integritetin si midis kolegëve ashtu si kundër edhe ndaj qytetarit
- sa me lartë të jeni në hierarki, aq më shumë rritet propabiliteti i keqpërdorimit të detyrës, kështu në këtë rast duhet patur kujdes.

Shembuj:

- Ji i sinqerte dhe i vërtetë
- Mos bëj me vetëdije formulime të kontekstit profesional me shkrim apo verbale fallco, në keqpërdorim të ligjit, shpërdorim të detyrës,
- Trego kurajo në të bërit atë që mendon se është e drejtë dhe ligji e lejon

Kodi britanik, rekomandohet si model sa i përket format strukturës së shkrimit të tij.

V. BIBLIOGRAFIA

- Council of Europe, "Deklarata mbi Policine", Rezoluta 690, (1979)
<http://assembly.coe.int/Documents/AdoptedText/ta79/ERES690.htm>
- Code of Ethics: Principles and standards of professional behavior for the policing profession of England and Wales", (2014)
- Council of Europe, "European Code of Police" Council of Europe Publishing, (2001)
- Ian. Ayres and John .Braithwaite, "Responsive Regulation", Oxford University Press, (1992)
- Instituti per Demokraci dhe Ndermjetesim, "Forcimi i Integritetit të Policisë së Shtetit: perceptime dhe eksperiencia mbi korrupsionin në polici", (2013)
- Instituti Studimeve te Opinionit Publik, "Kapacitetet dhe efektiviteti i programit të policimit në komunitet të Policisë së Shtetit: Zhvillimi i partneritete efektive pune me pushtetin lokal, qeverinë qendrore, OJF-të dhe komunitetet me fokus partneritetin me të rinjtë", Universiteti Tiranës, (2012)
- John Kleinig, "The Ethics of Policing", Cambridge University Press, London, UK, (1996)
- Judith. Lichtenberg "What are Codes of Ethics for?" in (ed.), Coady and Bloch. 13--27 (1996)
- Kodi Etikes se Policise, Ligj Nr. 8291. (1998)
- Lufta Kunder Terrorizmit; <http://gazeta-shqip.com/lajme/2014/10/20/lufta-kunder-terrorizmit-shqiperia-me-strukture-te-re-anti-terror/>
- Margaret. Coady and Sidney. Bloch, "Codes of Ethics and the Professions", Melbourne University Press, (1996)
- Seumas. Miller, "Model Code of Ethical Principles", Center for philosophy and public ethic, Melburn, Australia (2002).
- Stephen .Barker, "What is a Profession?" Professional Ethics vol.1 nos.1&2, (1992)
- Strategjia e Policise se Shtetit 2007-2013, http://www.asp.gov.al/pdf/Strategjia_Policise_Shtetit2007_2013.pdf

Organizata për Sigurim dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE), "Udhërrëfyes për Policim Demokratik nga Këshilltari i Lartë Policor i Sekretarit të Përgjithshëm të OSBE-së ", (2008

William Lyons, "The Politics of Community Policing: Rearranging the Power to Punish", University of Michigan Press, USA, (2002)